

VENDIM
Nr. 665, datë 19.10.2022

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 639, DATË 6.11.2017, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË
ORGANIKËS SË AGJENCISË SË AUDITIMIT TË PROGRAMEVE TË
ASISTENCËS, AKREDITUAR NGA BASHKIMI EVROPIAN, NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 21, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, dhe të pikës 4, të nenit 6, të ligjit nr. 90/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, Akredituar nga Bashkimi Evropian, në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 639, datë 6.11.2017, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:
 - a) Në pikën 3, shifra “21” zëvendësohet me “23”.
 - b) Në ndarjen IV, të skemës 2, “Organika e Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, Akredituar nga Bashkimi Evropian”, numri i audituesve të parë ndryshohet nga “2” në “4” dhe numri i përgjithshëm i punonjësve të kësaj ndarjeje ndryshohet nga “5” në “7”.
 2. Ngarkohet Agjencia e Auditimit të Programeve të Asistencës, Akredituar nga Bashkimi Evropian për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku